



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:298748
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05740283

Ac.nr.3183/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.B, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati P.D, kundër të paditurës “S.D.H” sh.p.k, , të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sh.A, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4974/19, të datës 27.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 23.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e paditëses D.B dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.4974/19, të datës 27.01.2022.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin ankimor, C.nr.4974/19, të datës 27.01.2022, ka vendosur më sa vijon:

I.REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses D.B, me të cilën ka kërkuar që të ANULOHET si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës, i datës 12.12.2019, me të cilin paditëses ju është shkëputur marrëdhënia e punës, si dhe DETYROHET, i padituri “S.D.H” sh.p.k, që paditësen ta kthej në vend të punës, sipas kontratës së punës, si dhe kompensimin e pagave të pa realizuara për periudhën nga data 12.12.2019 deri me datë 08.11.2021, pagat bruto për këtë periudhë shumën prej 62,141.63 €, si dhe pagesën në dobi të buxhetit të Kosovës shumën në vlerë prej 4, 674.82 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcenim të përmbarimit ligjor, NË TERËSI SI E PA BAZUAR.

II. Secila palë i bartë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditëses, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe Gjykata e Apelit të ndryshoj aktgjykimin dhe të aprovoj

kërkesëpadinë ose aktgjykimin të anulohet dhe çështjen ta kthejë në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe nenit 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditëses është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, pranë gjykatës së shkallës së parë, me datën 30.12.2019, ka paraqitur padi kundër të paditurës "S.D.H" sh.p.k, me, për kthim në punë dhe kompensimin e pagave, me detaje si në padi dhe të precizuar si në procesverbalin e datës 27.01.2022.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, duke arsyetuar se me provat e administruara, gjykata ka gjetur se paditja ka qenë në marrëdhënie punë tek e paditura me kontratë të punës me kohë të caktuar, për periudhën kohore duke filluar nga data 13.08.2019, deri me datë 12.08.2020, në pozitën e punës menaxhere e qendrës SPA dhe e paditura me njoftimin e datës 12.12.2019, e ka njoftuar paditësen për ndërprerjen e kontratës së punës me arsyetimin se paditësja nuk i ka arritur rezultatet e pritura, si marketing jo të duhur, mos realizim i të hyrave në W.C.S. Në arsyetimin e vendimit të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës thuhet se me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të "S.D.H", me datë 12 dhjetor 2019, ndaj paditëses është iniciuar procedura disiplinore për shkak të shkeljeve të detyrave të punës, Menaxhere e W.C.S në "S.D.H" dhe kryetari i Komisionit Disiplinor ka propozuar që paditëses ti ndërprehet kontrata e punës, për faktin se paditësja në periudhën 4 mujore nuk ka arritur rezultatet e pritura, dhe se qasja e saj ndaj stafit ka qenë jo profesionale duke kryer shkelje të rënda të detyrave të punës në kundërshtim me rregulloren e përgjegjësisë disiplinore dhe materiale, si dhe ka hasur ndesh me Kodin e Etikës dhe Mirësjelljes dhe se disa herë i është tërhequr vërejtja për higjienën. Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar theksohet se pasi konstatoi këtë gjendje faktike duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të ndërprerjes së njëanshme të marrëdhënies së punës nga ana e të paditurës iu referua Ligjit të Punës, konkretisht nenit 15 ku është përcaktuar "*Puna Provuese*" paragrafit 1 "*Puna Provuese përcaktohet me Kontratën e Punës*, dhe paragrafi 3 "*Gjatë periudhës provuese të punës, punëdhënësi dhe të punësuarit mund ta ndërpresin kontratën e punës me njoftim paraprak prej 7 ditësh*", e që në rastin konkret gjykata vendimin e konsideroi si vendim të ligjshëm ngase puna provuese është rregulluar me nenin 22 të kontratës së punës dhe se paditësja 7 dite më herët është njoftuar lidhur me ndërprerjen e punës.

Gjykata e shkallës së parë po ashtu në arsyetimin e aktgjykimin ka theksuar se pretendimet e palës paditëse se vendimi është marrë në kundërshtim me nenin 70 paragrafi 1 pika 1.6.2, të Ligjit të punës, gjykata i vlerësoj si jo të drejta për faktin se sipas kësaj dispozite parashihet se Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit "*përformanca e të punësuarit mbetet e pa kënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim*" në rastin konkret gjykata vlerëson se paditësja ka pas një kontratë më kohë të caktuar, mirëpo në nenin 22 të Kontratës të Punës të cilën paditësja e ka nënshkruar më datë 09.08.2019, është përcaktuar se "*periudha provuese në këtë kontratë është (4) muaj*", dhe se dispozita e nenit 70 paragrafi 1.6.2, e Ligjit të Punës, sipas gjykatës nuk e obligon të paditurin që ta paralajmëroj paditësen me shkrim për performancë, ngase paditësja ka

qenë në periudhë provuese dhe periudha provuese është e rregulluar me nenin 15 të po këtij ligji. Meqenëse, gjykata ka vendosur ta refuzoj kërkesëpadinë për shkak të bazës atëherë nuk është lëshuar fare në arsyetimin sa i përket ekspertizës financiare dhe shumë që do të mund ta realizonte paditësja sikur të punonte, pasi e drejta në kompensim të pagave në këtë rast është e varur nga anulimi i vendimit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe kthimit në punë. Mbi këto arsye gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 15, nenin 22 dhe nenin 70 paragrafi 1 pika 1.6.2 të Ligjit të Punës, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore i ka marr konform nenit 449, 450 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet e ankuesit për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë sepse në bazë të provave të administruara është vërtetuar drejt fakti vendimtar se ndërgjyqësit kanë qenë në marrëdhënie detyrimore të punës sipas Kontratës së Punës Nr.223 e datës 13/08/2019 e cila kontratë është lidhur në kohë të caktuar duke filluar nga data 13/08/2019 e deri me datën 12/08/2020 dhe me nenin 22 të kësaj kontrate, ndërgjyqësit janë pajtuar që periudha provuese të jetë 4 muaj. Në rastin konkret nuk ishte kontestuese fakti se ndërprerja e marrëdhënies së punës ndërmjet ndërgjyqësve ka ndodhur në periudhën provuese dhe e paditura me njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr.1082 i datës 12/12/2021 e ka njoftuar paditësen brenda periudhës prej 7 ditësh se Kontrata e Punë do të shkëputet me datën 19/12/2019, prandaj paditësja gjatë shqyrtimit kryesor me asnjë provë materiale nuk ka arritur të vërteton bazën juridike të kërkesëpadisë se të njëjtës i takon e drejta subjektive. Sipas nenit 7.1 të LPK-së është paraparë: *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*, ndërsa neni 319.1 të po këtij ligji ka paraparë: *Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta* ndërsa neni 322.3 i po këtij ligji ka paraparë: *Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër*.

Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i paditëses edhe sa i përket zbatimit të gabuar të ligjit material, për arsye se nuk ishte kontestuese se paditësi e ka realizuar pagën e kontraktuar ashtu siç janë dakorduar palët me kontratë dhe sipas nenit 15.1 dhe 3 të Ligjit të Punës, parashihet: *Puna*

provuese përcaktohet me Kontratën e Punës. Gjatë periudhës provuese të punës, punëdhënësi dhe të punësuarit, mund ta ndërpresin marrëdhënien e punës me njoftim paraprak prej shtatë (7) ditësh, që nënkupton se e paditura me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, nuk e ka cenuar asnjë dispozitë ligjore dhe kontraktuale dhe me nenin 8.1 të LMD-së parashihet: Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit. Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të pa themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkëlqje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura, Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.3183/22, me datë 23.05.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku